



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 49 Prot

Tiranë, më 13.07. 2007

VENDIM Nr. 9 dt. 25.06.2007

Që mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9592, datë 27.07.2006, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, dt 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 25.06.2007, pasi shqyrtoi projektet e paraqitura në rendin e ditës

VENDOSI:

1. Miratimin e shtesës së volumit në ndërtesën e ish Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, sipas volumeve dhe strukturave kryesisht me xhama, për ta kthyer këtë objekt në godinën e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
 2. Të shikohet monumenti Kalaja e Lezhës në vend, për të gjykuar më saktë lidhur me projektin e paraqitur, për restaurimin e saj.
- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
 - Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
PROF. DR. YLLIPANGO